



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:204383

Datë: 19.01.2024

Numri i dokumentit: 05215776

C.nr.1463/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. M., L.Xh., F. K., M. Ç., A. M., të cilët sipas autorizimit më shkrim i përfaqëson avokat Leutrim Ademi, nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit më shkrim e përfaqëson Arbnor Murturi, avokat në Prishtinë. Objekt kontesti “Kompensim e te ardhurave nga marrëdhënia e punës”, si dhe “shtesat ne page për shkak te inflacionit,” Jashtë seancë gjyqësore, më datën 19.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË POHIMIT

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A. M., L.Xh., F. K., M. Ç., A. M., ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë, që paditësve në emër të kompensimit për ushqim gjatë pranisë në punë shujtave ditore dhe shtesave ne pagë-inflacion gjatë punës, ti kompensoj si vijon.

- Paditësit A. M., ne emër te shujtave ditore për periudhën kohore prej 12.03.2020 deri me 30.12.2020 apo për 66 ditë te prezencës ne punë, (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro) në shumen e përgjithshme prej 132.00 euro, si dhe në emër të kompensimit të shtesave në page-inflacion për periudhën kohore 04.04.2019 deri me datën 30.12.2020 ne shumen e përgjithshme prej 134.75 euro.
- Paditësës L.Xh. ne emër te shujtave ditore për periudhën kohore prej 12.03.2020 deri me 30.12.2020 apo për 70 ditë te prezencës ne punë, (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro) në shumen e përgjithshme prej 140.00 euro, si dhe në emër të kompensimit të shtesave në page-inflacion për periudhën kohore 04.04.2019 deri me datën 30.12.2020 ne shumen e përgjithshme prej 133.29 euro.
- Paditësës F. K. në emër te shujtave ditore për periudhën kohore prej 12.03.2020 deri me 30.12.2020 apo për 69 ditë te prezencës ne punë, (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro) në shumen e përgjithshme prej 138.00 euro si dhe në emër të kompensimit të shtesave në page-inflacion për periudhën kohore 04.04.2019 deri me datën 30.12.2020 ne shumen e përgjithshme prej 133.29 euro.

- Paditëses M. Ç, në emër të shujtave ditore për periudhën kohore prej 12.03.2020 deri me 30.12.2020 apo për 68 ditë te prezencës ne punë, (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro) në shumen e përgjithshme prej 136.00 euro si dhe në emër të kompensimit të shtesave në page-inflacion për periudhën kohore 04.04.2019 deri me datën 30.12.2020 ne shumen e përgjithshme prej 135.09 euro.
- Paditësit A. M, në emër te shujtave ditore për periudhën kohore prej 12.03.2020 deri me 30.09.2020 apo për 69 ditë te prezencës ne punë, (për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro) në shumen e përgjithshme prej 138.00 euro, si dhe në emër të kompensimit të shtesave në page-inflacion për periudhën kohore 04.04.2019 deri me datën 30.12.2020 ne shumen e përgjithshme prej 130.06 euro.

Për secilin paditës veç e veç me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data 14.09.2021 datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. APROVOHET PJESERISHT SI BAZUAR kërkesa e paditëseve lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës – Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësve tua paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 332.00 €, të gjitha këto ti përmbush në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET PJESËRISHT SI E PA BAZUAR përtej pjesës së aprovuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi kërkesa e paditësve lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, me të cilën kanë kërkuar në emër të dy precizimeve të kërkesëpadisë për kompensim për shujtë ushqimore dhe kompensim te inflacionit ne page, si dhe kërkesës ne komune, t'ua paguaj e paditura shumën prej 312€,00 €.

A r s y e t i m

Paditësi A. M., L.Xh., F. K., M. Ç., A. M, nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 14.09.2021, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti *“kompensimin i të ardhurave nga marrëdhënia e punës”, si dhe “shtesat ne page për shkak te inflacionit.*

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, fillimisht vërejti se padia është përpiluar në tërësi në përputhje me dispozitën nga neni 253, lidhur me nenin 99 të LPK, pas plotësimit të kushteve ligjore, të njëjtën (padinë me dokumentet e bashkangjitura në të), më Aktvendimin që mbanë shenjen C.nr.1463/2021, të datës 11.12.2023, e detyron të paditurën që në afatin prej 15 ditësh të paraqes përgjigje në padi, nën kërcënimin e pasojave juridike. Tutje, e paditura më parashtrësën e datës 26.12.2023, (përgjigjën në padi) e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurit, konstatoi se në këtë çështje kontestimore kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët mund të disponojnë lirshëm, në kuptim të nenit 148 paragrafit 1 të LPK, me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)”* vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën ligjorë të kërkuar nga paditësi, duke qenë se e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, gjykata ka vendosur që kamatë vonesa të jetë prej 8%, duke u bazuar në nenin bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit padisë në gjykatë (14.09.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e Gjykata vendosi si në piken II te dispozitivit.

Gjykata aprovoj pjesërisht shpenzimet e procedurës kontestimore si ne piken III te dispozitivit te këtij aktgjykimi ne mbështetje të nenit 452 të LPK-së, ashtu që detyrohet e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padis shumen prej 312 euro për taksen për padi shumen prej 20 euro gjithsej prej 332 euro- sipas tarifës së OAK.

Gjykata refuzoj si te pa bazuar si ne piken IV te këtij Aktgjykimi, kërkesën për shpenzimet sa i përket precizimit të kërkesëpadisë ne shumen prej nga 312 euro, pasi qe te njëjtat konsiderohen petitum i padisë.

Prandaj, gjykata bazuar ne arsyet e cekura me larte si dhe duke u bazuar ne nenin 148 te LPK, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1463/2021, datë 19.01.2024

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit se të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.